



## KOMUNIKATË

**15.10.2009**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen 42-të të kryesuar nga Kryetarja znj. Nesrin Lushta, fillimisht ka miratuar rendin e ditës dhe, raportet nga mbledhjet e kaluara nr. 35, 37 dhe 39. Kryetarja Nesrin Lushta, foli për Deklaratën vlerësuese të situatës parazgjedhore në Kosovë të bërë nga Instituti Nacional Demokratik (NDI). “Vlerësimet e situatës parazgjedhore janë mjaft të mira nga ky institut”, ka thënë znj. Lushta, e cila e ka falënderuar NDI-në, për këtë vlerësim.

Kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani, paraqiti me shkrim pasqyrë përmbledhëse të aktiviteteve të Zgjedhjeve të 15 Nëntorit, e ku përfshihet buxheti i KQZ-së për vitin 2009, Sistemi i Votimit, Përpilimi i Listës Votuese, Shërbimi Votues, Periudha e Konfirmimit dhe e Kundërshtimit, Votimi, Angazhimi i Subjekteve Politike dhe, të dhënat krahasuese të Zgjedhjeve në Kosovë 2000-2009. Kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani, lidhur me periudhën e Konfirmimit dhe Sfidimit të Votimit me Postë, ka folur në mënyrë të veçantë lidhur me numrin e kërkesave për sfidim të së drejtës. Kërkesa për sfidim të së drejtës për të votuar kanë qenë 14, numri i kërkesave për t’i konfirmuar të dhënat ka qenë 139, numri i kërkesave të marra nga Gjykata e shkallës së Parë është 11 dhe numri i personave të larguar nga lista votuese nga gjykata është 5.

Në vazhdim të mbledhjes, Drejtoresha e Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike, ka paraqitur për shqyrtim dy kërkesa të dy kandidatëve të subjektit politik të certifikuar për zgjedhjet Partia Socialdemokrate (PSD) për tërheqjen nga lista zgjedhore. Mirëpo, anëtarët e KQZ-së, nuk i kanë miratuar këto kërkesa për shkak se afatet ligjore tashmë janë të kaluara dhe, certifikimi është i mbyllur. ZRPP, gjithashtu ka rekomanduar akreditimin për vëzhgim të procesit zgjedhor të dy organizatave ndërkombëtare, dhe të Ambasadës së Republikës së Sllovenisë. KQZ ka aprovuar rekomandimin e Rrjetit Evropian të Organizatave Monitoruese të Zgjedhjeve “ENEMO” me 6 vëzhgues, Këshillin e Rajoneve të Bashkësisë Evropiane me 4 vëzhgues, dhe Ambasadën e Republikës së Sllovenisë me 1 vëzhgues.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në këtë mbledhje ka diskutuar edhe për Projektin Publik për Transmetimin në TV dhe në Radio. Betim Gjoshi, anëtar i KQZ-së . shpjegoi veprimet për përmbushjen e obligimeve që dalin lidhur me Informimin Publik. Ky është një aktivitet i rëndësishëm për procesin zgjedhor. Duke pasë për bazë faktin që spotet në

TV dhe në Radio, duhet ta mbulojnë të gjithë teritorin e Republikës së Kosovës, është e nevojshme poashtu sensibilizimi i daljes në zgjedhje dhe, informimi rreth mënyrës së votimit brenda dhe jasht vendit. Ky projekt, u miratua nga KQZ.s

Besnik Buzhala ( Departamenti i Operacioneve Zgjedhore), ka folur rreth operacionit të Votimit me Postë. Buzhala, tha se janë shpërndarë rreth 30.000 aplikacione për Votim me Postë. Totali i aplikacioneve të pranuar si të rregullta ka qenë 2630 aplikacione. Janë aprovuar 1806 aplikacione, ndërsa janë refuzuar 824 aplikacione.

Në këtë mbledhje, janë shryrtuar edhe miratuar Këshillat e Vendvotimeve në Leposaviq dhe Zubin Potok, Graçanicë. KQZ nuk i ka miratuar Këshillat e Vendvotimeve për Komunën e Prishtinës.